



Prishtinë: 06.04.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1246_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2033_01_20**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **28.02.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 06.04.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit R. Ll. nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2033** i datës 31.01.2020.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 28.02.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori R. Ll. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se nuk është i kënaqur me vendimin e organit të shkallës së parë dhe kërkon rishqyrtimin e tij. Konsumatori në ankesë ka theksuar se fillimisht i është thënë të paguaj vetëm 20% për ndërrimin e njehsorit pastaj KEDS e ka ngarkuar me komplet ngarkesën.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 06.04.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se nuk është i kënaqur me vendimin e organit të shkallës së parë dhe kërkon rishqyrtimin e tij, Bordi i ZRRE thekson se bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, konsumatorët ose të licencuarit mund të apelojnë vendimin e DMK-së në Bordin e ZRRE brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga dita e pranimit të vendimit nga konsumatori, dhe se pastaj Bordi i ZRRE bazuar në të gjitha shkesat e lëndës ka mandat të shqyrtoj ankesën e juaj kundër vendimit të organit të shkallës së parë të ZRRE.

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës dhe ka vërejtur se bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe transaksionet e konsumatorit konstatohet shifra DPR – 2001865 është hapur



me datë 19.03.2007 dhe atë me faturë të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve), e me njehsor nr.39960390, dhe se kjo shifër fillimisht është regjistruar në emër të Mishtore "Qingj" IL. B.Sh. Fatura e parë e energjisë elektrike i është ardhur konsumatorit në muajin 04/2007, dhe se ka qenë i regjistruar si konsumator ilegal. Faturat e energjisë elektrike të muajve 04/2007, 05/2007 dhe 06/2007 janë shkuar në emër të Mishtore "Qengji" – B.Sh. Bzuar në rrjedhën e energjisë elektrike vërehet se në periudhën 04/2017 gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë TL=250 kWh dhe TU=1110 kWh. Pra nga kjo shihet qartë se në momentin e faturës së rikthimi të humbjeve të datës 19.03.2007 dhe faturës së parë të energjisë elektrike 04/2007, njehsori elektrik nr.39960390 ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik, e që sipas rregullave në fuqi nuk është dashur të jetë njehsori i kyçur në rrjetin elektrik pa autorizim të KEDS-it.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka vërejtur se konsumatori R.Ll. me datë 27.09.2016 ka parashtruar kërkesë në KESCO/KEDS duke kërkuar që t'i ofrohet lidhja e re, por që me datë 27.10.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë pranimin e njehsorit elektrik nr.39960390 me gjendje TL=14000 kWh dhe TU=61490 kWh, si dhe kanë theksuar se afër shifrës IL – 2001865, si dhe kanë theksuar se njehsori është teknikisht në rregull dhe se tani duhet të legalizohet shifra. Gjendja e shpenzimeve të njehsorit elektrik nr.39960390 e evidentuar në procesverbalin pranimit të instalimit elektrik nr.0096264 të datës 27.10.2016 vërteton se njehsori elektrik ka qenë i kyçur në rrjet para pranimit teknik të kyçjes nga ana e KEDS. Pra, pas pranimit të kërkesës për lidhje të re, KEDS nuk ka bërë lidhje të re, por ka regjistruar konsumatorin në shifrën DPR – 2001865, pasi që sipas KEDS-it aty veç se ka qenë shifra e hapur dhe se duhet vetëm të bëhet legalizimi i shifrës dhe të bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik. Bordi i ZRRE poashtu gjatë analizave të bëra shkresave të lëndës ka vërejtur se ekziston edhe Kontrata për qera të lokalit afarist të nënshkruar me datë 07.03.2016 në mes të Ndërmarrjes Publike Banesor dhe NTSH "Qengji" – R.Ll. me të cilën objekt i kësaj kontrate është lokali afarist në laxhen "Ulpiana" nr.20/1 në Prishtinë.

Bordi i ZRRE thekson se janë të plotësisht të sakta konstatimet e dhëna në vendimin e organit të shkallës së parë të ZRRE e në të cilën theksohet se konsumatori i cili ka shfrytëzuar energjinë elektrike në njehsorin elektrik nr.39960390 në periudhën 19.03.2007 nuk është dashur të kyçet në rrjetin elektrik pa parashtruar kërkesë për lidhje të re, e që me këtë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Rregullës për Kushtet e Furnizimit me Energji, dhe se për këtë kyçje të paautorizuar të KEDS-it konsumatori është faturuar me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë dhe si konsumator ilegal dhe ky regjistrim si ilegal ka vazhduar deri më kërkesën e konsumatorit për lidhje të re të datës 27.09.2016 dhe se me datë 27.10.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë pranimin e njehsorit elektrik nr.39960390 e me gjendje TL=14000 kWh dhe TU=61490 kWh, si dhe pas kësaj në po të njëjtën datë është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik, ku është larguar njehsori i vjetër dhe është vendosur njehsori i ri. Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se është plotësisht e saktë që Ndërmarrja Publike Banesore është qeradhënësi i lokalit afarist në lagjen Ulpiana nr.26/1, dhe se është përgjegjëse për qeramarrësit të cilët marrin lokalit afarist, e që në rastin konkret konform provave faktike konstatohet se energjia elektrike në këtë lokal fillimisht është kyçur në periudhën 19.03.2007 dhe atë si shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike, respektivisht pa lejen e autorizuar të KEDS, e që është në kundërshtim me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji si dhe Procedurën Lidhëse, pasi për tu kyçur në rrjetin elektrik duhet të parashtrohet kërkesa për lidhje të re, pastaj punëtorët e autorizuar të KEDS duhet të dalin në teren dhe të shikojnë se a janë plotësuar të gjitha kushtet teknike për tu kyçur në rrjetin elektrik.

Sipas nenit 7 paragrafi 1 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji "Operatorët e sistemit duhet të zhvillojnë Metodologjinë e taksave për kyçje në përputhje të plotë me Metodologjitë Tarifore të miratuara nga ZRRE-ja". Sipas Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe Procedurës Lidhëse, konsumatorët të cilët aplikojnë për lidhje të re faturohen me taksën për



shërbime për lidhje të re bazuar në çmimoren e aprovuara nga ZRRE e në të cilën janë të përshkruara dhe paraqitura të gjitha taksat që duhen të zbatohen nga operatorët me rastin e aplikimit të konsumatorit. Duhet theksuar se neni 5, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.5 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thekson se: *“Operatori i Sistemit duhet të: bëjë kyçjen në rrjet të çdo aplikuesi nëse kjo kyçje është teknikisht e mundshme sipas kushteve të vendosura në Marrëveshjen për Kyçje, dhe ta ngarkojë me taksë të përcaktuara në pajtim me metodologjinë të përcaktimit të taksave të kyçjes”*, si dhe neni 5, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.8 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thekson se: *“Operatori i Sistemit duhet të: arkëtojë prej shfrytëzuesve të sistemit taksat për shfrytëzim të sistemit”*

Bordi i ZRRE konstaton se është plotësisht e saktë konstatimi i organit të shkallës së parë të ZRRE ku theksohet se qeramarrësi aktual nuk ka të bëjë me taksën për lidhje të re të ngarkuar nga KESCO, mirëpo në shifrën DPR – 2001865 e cila ka ekzistuar që nga periudha 19.03.2007 dhe e cila vazhdimisht nga ajo periudhë ka pasur shpenzime të energjisë elektrike duhet të ngarkohet taksë për lidhje të re dhe se është çështje e marrëveshjeve kontraktuale mes qeradhënësit Ndërmarrjes Publike Banesore dhe qeramarësve të definojnë se kujt duhet t’i takoj taksë për lidhje të re, por që në shifrën DPR – 2001865 duhet të ngarkohet taksë e lidhjes së re.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 06.04.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Boardi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit R.Ll.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.